# SOCIOLOGJI RURALE

| Të dhëna bazike të lëndës | |
|---|---|
| **Njësia akademike:** | Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit |
| **Titulli i lëndës:** | Sociologji Rurale |
| **Programi:** | Agrobiznes |
| **Niveli:** | Bachelor |
| **Statusi lëndës:** | Obligative (O) |
| **Viti i studimeve:** | Viti 1 / Semestri 1 |
| **Numri i orëve në javë:** | 2 + 2 |
| **Vlera në kredi – ECTS:** | 5 ECTS |
| **Koha / lokacioni:** | Do të shpallet |
| **Mësimdhënësi i lëndës:** | Prof. Ass. Dr. Besim Gallopeni |
| **Të dhënat kontaktuese:** | besim.gollopeni@gmail.com |
| | |
| **Përshkrimi i lëndës:** | Ky kurs u ofron studentëve kuptimin e lindjes dhe zhvillimit të sociologjisë; Raporti i sociologjisë me shkencat tjera shoqërore; Metodat shkencore në sociologji; Nocione të përgjithshme mbi bashkësinë dhe familjen rurale; Karakteristikat themelore të fermave rurale; Vështrim sociologjik mbi vendbanimet rurale; Aspekti sociologjik i marrëdhënieve të fermerit me shoqërinë; Çështje të përgjithshme midis sociologjisë rurale me marrëdhëniet pronësore; Mentaliteti i ekonomisë së tregut dhe prodhimi bujqësor; Kooperimi në ekonominë bujqësore - në kushtet e ekonomisë së tregut; Veçoritë kryesore të jetës fizike të popullsisë; Kultura dhe arsimi – si forma të civilizimit njerëzor në zonat rurale; Shtresat shoqërore, lëvizjet sociale dhe migracioni si formë i lëvizjeve sociale; Procese të zhvillimit ekonomik dhe social në zonat rurale të Kosovës dhe Shqipërisë. |
| | |
| **Qëllimi i lëndës:** | Objektivi kryesor i kësaj lënde është që studentëve t'u ofrojë njohuri themelore dhe qasje bashkëkohore mbi kategoritë themelore të sociologjisë në përgjithësi dhe asaj rurale në veçanti. Të kuptojnë dhe analizojne rrjedhat e gjithëmbarshme të zhvillimit shoqëror, politik dhe demokratik të shoqërisë bashkëkohore, si dhe të zhvillojnë ndjenjën e tolerancës dhe të respektimit të mendimit të të tjerëve në kuptimin e proceseve dhe fenomeneve të ndryshme shoqërore. |
| | |
| **Rezultatet e të nxënit**: | Pas përfundimit të kursit, studentët do të jetë në gjendje të:<br>▪ Të fitojnë njohuri shkencore dhe profesionale mbi sociologjinë rurale si shkencë mbi shoqërinë rurale dhe kushtet apo rrethanat historike të lindjes së saj, që t'i kuptojnë rregullat e jetës në bashkësinë rurale, tipet e komunitetit rural si dhe raportet e tyre në bashkësinë rurale;<br>▪ Të kuptojnë dhe analizojne rëndësinë dhe interesin e bashkëveprimit të njerëzve në vendbanimet rurale si dhe disa çështje aktuale lidhur me lindjen e vendbanimeve të reja;<br>▪ Të kuptojnë dhe analizojne rëndësinë dhe mentalitetin e ekonomisë së tregut dhe prodhimit bujqësor dhe ndihmën e shtetit ndaj faktorit njerëzor në zonat rurale si dhe ndikimin e |

| | |
|---|---|
| | faktorëve natyror, social, ekonomik dhe psikologjik në jetën fizike të popullsisë rurale;<br>▪ Të jenë në gjendje t'i kuptojnë, analizojne dhe gjykojne më drejtë çështjet që kanë të bëjnë me shtresat sociale, me lëvizjet sociale dhe migracionin si formë e lëvizjeve sociale – me mobilitetitn dhe eksodin rural e para së gjithash, me shkaqet e eksodit rural në botë, etj. |

| Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit) | | | |
|---|---|---|---|
| **Aktiviteti** | **Orë** | **Ditë/javë** | **Gjithsej** |
| Ligjërata | 2 | 15 | 30 |
| Ushtrime teorike/laboratorike | 1 | 15 | 15 |
| Punë praktike | | | |
| Kontaktet me mësimdhënësin (konsultimet) | 0,5 | 15 | 7.5 |
| Ushtrime në teren | | | |
| Kollokviume, seminare | 0.5 | 15 | 7.5 |
| Detyra të shtëpisë | | | |
| Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi) | 3 | 15 | 30 |
| Përgaditja përfundimtare për provim | 3 | 15 | 30 |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final) | | | |
| Projektet, prezentimet etj. | 1 | 5 | 5 |
| **Totali** | | | **125 orë (5 ECTS)** |

| | |
|---|---|
| **Metodologjia e mësimdhënies:** | Ligjërata, ushtrime, diskutime, konsultime, projekte kursi, detyra shtëpie, kollokviume, provimi përfundimtar. |
| **Metodologjia e vlerësimit:** | ▪ Vijueshmëria e rregullt dhe aktive: 10%,<br>▪ Provimi i ndërmjemë (kollokviumi): 20%,<br>▪ Projekti i kursit: 10%,<br>▪ Provimi final: 60%. |
| **Literatura** | |
| **Literatura primare:** | Muçaj, Agim (2013) Sociologjia Urbane dhe Rurale, UBT, Tiranë.<br>Mazniku, Luljeta & Canaj, Elidiana (2008) Sociologji Rurale, Tiranë. |
| **Literatura shtesë:** | Canaj, E., (2010) Ndikimi i mendësive fisnore – monografi, Geer, Tiranë.<br>Anthony, G., (2002) Sociologjia, Tiranë: SOROS.<br>Mulla, Gjyldane (2000) Sociologji Urbane, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë.<br>Axhemi, Sokol (2008) Gjeografia Sociale, ALSA, Trianë.<br>UNESKO, (2000) Sfidat e Shek. XXI, (kapitulli: e ardhmja e punës, e ardhmja e kohës). |

| | |
|---|---|
| | Adrian Civici, (2012) Globalizimi, Ante Pontas, UET – Press, Tiranë.<br>Ralf Dahrendorf (2006) Njeriu Sociologjik, plejada e mendimit sociologjik, Plejad, Tiranë.<br>Islami, Hivzi (2005) Studime Demografike – 100 vjet e zhvillimit demografik të Kosovës. ASHAK, Prishtinë. |

| **Plani i dizajnuar i mësimit:** | | |
|---|---|---|
| **Java** | **Ligjërata** | **Ushtrime** |
| ***Java e parë:*** | Sociologjia Rurale – shkenca mbi shoqërinë rurale; Lindja dhe objekti i studimet;<br>Shtrirja hapësinore dhe teoritë;<br>Diskutim i lirë (rreth 5-10 min.)… | Shpërndarja e temave të projekteve seminarike. |
| ***Java e dytë:*** | Bashkësia Rurale;<br>Ekonomitë familjare dhe transformimi i tyre; Diskutime; | Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës parë të ligjëratave. |
| ***Java e tretë:*** | Familja Rurale;<br>Karakteristikat e familjes rurale;<br>Strukturat ekonomike të popullsisë rurale;<br>Diskutim i lirë… | Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës dytë të ligjëratave. |
| ***Java e katërt:*** | Fermat rurale – tiparet e ndryshimet e tyre social-ekonomike;<br>Shoqëria agrare dhe karakteristikat e saj;<br>Dendësia e përgjithshme dhe dendësia agrare;<br>Diskutim i lirë… | Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës tretë të ligjëratave. |
| ***Java e pestë:*** | Vendbanimet rurale;<br>Dendësia e vendbanimeve, shtrirja hapësinore dhe funksioni i tyre;<br>Diskutim i lirë… | Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës katërt të ligjëratave. |
| ***Java e gjashtë:*** | Sociologjia e marrëdhënieve të fermerit me shoqërinë;<br>Struktura homogjene dhe e pazhvilluar;<br>Transformimet rurale në mënyrën e jetesës dhe marrëdhënieve prodhuese;<br>Diskutim i lirë… | Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës pestë të ligjëratave. |
| ***Java e shtatë:*** | Kolokviumi / Vlerësimi intermediar - Debate. | Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës gjashtë të ligjëratave. |
| ***Java e tetë:*** | Sociologjia e marrëdhënieve pronë-sipërmarrje në bujqësi;<br>Diskutim i lirë… | Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës shtatë të ligjëratave. |
| ***Java e nëntë:*** | Faktori njerëzor në prodhimin bujqësor. Analiza sociologjike e fermës rurale;<br>Diskutim i lirë … | Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës tetë të ligjëratave. |
| ***Java e dhjetë:*** | Karakteristikat kryesore të jetës fizike të popullsisë rurale;<br>Diskutim i lirë ... | Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës nëntë të ligjëratave. |

| | | |
|---|---|---|
| ***Java e njëmbëdhjetë:*** | Konceptet kryesore të kulturës së grupeve sociale rurale dhe arsimi si pjesë e kulturës<br>Diskutim i lirë ... | Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës dhjetë të ligjëratave. |
| ***Java e dymbëdhjetë:*** | Shtresat Sociale. Lëvizjet Sociale. Migracioni si formë e lëvizjeve sociale;<br>Diskutim i lirë... | Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës njëmbëdhjetë të ligjëratave. |
| ***Java e trembëdhjetë:*** | Llojet e migracionit dhe ndikimi në transformimin e shoqërisë rurale;<br>Diskutime... | Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës dymbëdhjetë të ligjëratave. |
| ***Java e katërmbëdhjetë:*** | Shkaqet dhe efektet e migracionit lokal dhe ndërkombëtar në rrjedhat e bashkësisë rurale; Teknologjia dhe ndryshimet në rrjedhat rurale; Diskutim i lirë; | Detyra të zgjedhura, kuize dhe raste studimore nga tema e javës trembëdhjetë të ligjëratave. |
| ***Java e pesëmbëdhjetë:*** | *Përmbledhje dhe diskutime të përgjithshme;*<br><br>*Testi – kolokvium;* | Prezantimi dhe diskutimi i projekteve semestrale të studentëve. |

**Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

- Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe Kodin e etikës.
- Studenti duhet të respektojë orarin e ligjeratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm.
- Studenti posedojë dhe paraqesë ID kartën në provime e ndërmjeme dhe provime përfundimtare,
- Gjatë hartimit të projekteve të kursit, studenti duhet t'i përmbahet udhëzimet e dhëna nga mësimdhënësi.
- Gjatë orës së provimit është i ndaluar përdorimi i celularëve.